

Prof.dr. Zyhdi DERVISHI

## MIRËKUPTIMI NDËRFETAR TE SHQIPTARËT

Toleranca fetare, ose më saktësisht toleranca ndërfetare, mirëkuptimi, harmonia ndërfetare e shqiptarëve, është një nga tri vlerat kulturore më të spikatura (krahas vlerës kulturore të besës dhe të mikpritjes) të kulturës shqiptare. Një nga njohësit më të kualifikuar të kulturës tradicionale shqiptare, shkrimtari, përkthyesi dhe eseisti erudit Faik Konica ka shkruar: “Unë besoj se dihet gjithkund që shqiptarët janë tolerantë për besimet e tjera dhe, ndoshta, ky është i vetmi vend në Evropë, ku nuk ka pasur luftëra fetare. Për këtë arsye disa kanë folur shpesh për “skepticismin” shqiptar (Konica, F., 2001:241). Ky është ndoshta karakterizimi më lakonik, i cili ndriçon jo vetëm thelbin e njërit prej “segmenteve” më komplekse e interesante të realitetit psikokulturor të shoqërisë shqiptare, tradicionale e moderne, por edhe optikën e vështrimeve të këtij realiteti nga studiuesit, udhëpërshkruesit dhe, përgjithësisht, mendimtarët e huaj.

### I. Mirëkuptimi ndërfetar - vlerë kulturore e njohur, por pak e argumentuar

Në shkrimet e mendimtarëve dhe udhëpërshkruesve joshqiptarë gjenden mjaft karakterizime për këtë çështje. Për shembull, Hugo Adolf Bernatzik për shoqërinë shqiptare të vitit 1929, kur ai vizitoi mjaft qytete e krahina të Shqipërisë, ka shkruar: “Katolikë, të krishterë ortodoksë dhe muslimanë jetojnë në paqe në këtë vend të vogël, madje, shpesh edhe në fshatra jetojnë së bashku. Luftërat fetare janë të panjohura dhe të pakonceptueshme për shqiptarin” (2003:154). Mirëkuptimi, bashkëjetesa harmonike ndërfetare e shqiptarëve ka funksionuar dhe funksionon në çdo nivel organizimi shoqëror, në radhët e banorëve të qyteteve, të krahinave rurale e deri të fshatrave, ndërmjet anëtarëve të fiseve

dhe deri të familjeve. Rreth dy shekuj më parë, kur psikozat e fanatizmit ndërfetar në Evropë e më gjerë ishin më të skajshme e më problematike, një nga njohësit më në zë të shoqërisë e të kulturës shqiptare, udhëpërshkruesi anglez William Martin - Leake, veç të tjerash, ka nënvizuar: "Muslimanët shqiptarë... martohen me gra të krishtera, djemtë shkojnë në xhami dhe vajzat në kishë, ndërsa burri (musliman - Z.D.) ha në të njëjtën tryezë e, shpesh po nga ajo enë, në anën përballë të së cilës, një pjesë e familjes së tij po ushqehet me mish (derri - Z.D.) që është "i ndaluar" për burrin musliman (2006:142). Kësisoj, mjaft shqiptarë kanë jetuar dhe jetojnë në përbërje të fiseve, të familjeve plurifetare.

Po të shpreheshim me gjuhë disi të figurshme, vlera kulturore e tolerancës ndërfetare të shqiptarëve ngjan me një margaritar, të qëndrueshëm e identifikues për shqiptarët në rrjedhën e shumë shekujve deri në ditët tona, por i pashpjeguar sa e si duhet së brendshmi dhe, përgjithësisht, nga jashtë shoqërisë shqiptare, i keqkuptuar dhe i keqinterpretuar. Ndaj mendojmë se është e nevojshme që shkrimtarët, analistët dhe sidomos studiuesit shqiptarë të angazhohen më intensivisht për të tejkaluar sa më shpejt vakuume të tilla.

Çështja e mirëkuptimit ndërfetar të shqiptarëve shfaqet si rebus, gati i padeshifrueshëm në sfondin e dyfishtë të realitetit socialkulturor mbizotërues të shumë shoqërive të ditëve tona të cilat përjetojnë konfliktime fetare *problematike* dhe të një mjegulle të dendur paragjykimesh që vjen nga jashtë dhe deformat pamjen e vlerave të shoqërisë shqiptare.

Së paku që nga koha e kryqëzatave (shekulli XII-XIII) deri në ditët tona konfliktet, luftërat ndërfetare janë ndezur e fashitur herë pas here në rajone të ndryshme të botës, duke shkaktuar një numër të madh viktimash dhe njerëzish të gjymtuar fizikisht e shpirtërisht. "*Gjatë Mesjetës, - ka shkruar Anthony Giddens, - kishte pak a shumë një luftë të pandërprerë ndërmjet Evropës së krishterë dhe shteteve muslimane...*" (1997:452). Gjithashtu, edhe një nga studiuesit më të kualifikuar të konflikteve ndërkulturore, ndërqytetërore e ndërfetare të ditëve tona, Samuel Huntington, ka shkruar: "Në Ksingingang, ujugurët dhe grupet e tjera muslimane luftojnë asimilimin dhe po ndërtojnë marrëdhënie me fafesisin e tyre etnik e fetar në ish-republikat sovjetike. Në nënkontinent,

Pakistani dhe India kanë bërë tri luftëra, një lëvizje kryengritëse e muslimanëve kundërshton sundimin e Indisë mbi Kashmirin. Emigrantët muslimanë luftojnë kundër fiseve në Asam, kurse muslimanët dhe hindutë herë pas here përleshën e ushtrojnë dhunë përmes gjithë Indisë dhe këto shpërthime ushqehen nga ngritja e lëvizjeve fundamentaliste në të dyja bashkësitë fetare. Në Bangladesh budistët protestojnë kundër diskriminimit që u bëhet prej shumicës muslimane, ndërsa në Mianmar muslimanët protestojnë kundër diskriminimit që u bën shumica budiste. Në Malajzi e Indonezi periodikisht muslimanët ngrenë krye në ekonomi. Në Tajlandën e Jugut grupet muslimane janë përfshirë herë pas here në kryengritje kundër qeverisë budiste, kurse në Filipinet e jugut një lëvizje kryengritëse lufton për pavarësi nga vendi dhe qeveria katolike. Nga ana tjetër, në Indonezi timorasit lindorë katolikë luftojnë kundër shtypjes prej qeverisë muslimane” (2004:422-423). Natyrisht, këto janë luftëra për interesa ekonomike, nacionale etnike etj. Por në luftëra të tilla përmbajtja fetare është mjaft e dukshme dhe mjaft ndikuese.

Në këtë botë tejet të trazuar edhe nga konfliktet ndërfaqetare, shqiptarët janë të paragjykuar si popull *më shumë i prirur nga konfliktet, sesa nga mirëkuptimi*. Këtë paragjykim janë përpjekur ta bazojnë në argumente teorike, sociologjike dhe sidomos psikologjike mjaft gazetarë, udhëpërshkrues dhe studiues të huaj. Për shembull, prifti françeskan kroat Lavro Mihaçević, i cili për gati dy dhjetëvjeçarë (ndërmjet viteve 1883 dhe 1907) ka shërbyer si prift, si mësues e studiues i traditave kulturore të shqiptarëve në terren në disa vise të Shqipërisë, ndër të tjera, ka shkruar: “Shqiptarët janë nga temperamenti në përgjithësi kolerikë. Sa çel e mbyll sytë kalojnë nga njëri skaj në tjetrin, janë të vendosur dhe të gatshëm për aksion. Nuk mund t’i shikosh të zihen me fjalë, nuk janë ngatërrestarë, nuk shajnë e fyejnë njëri-tjetrin. Po që se në ndonjë kontekst që kanë, hidhërohen njëri me tjetrin, ata atë punë e zgjidhin aty për aty, kapin pushkën dhe sa ora e flamisin konfliktin ose, nëse nuk vriten aty për aty, më vonë i qërojnë llogaritë duke iu hakmarrë njëri-tjetrit. Lehtë mund të ndodhë që dy vetë janë ulur dhe këndojnë bashkë, kur pa prituri e pa menduar, çohen në këmbë dhe nxjerrin koburet për të vrarë njëri-tjetrin. Për këtë, në biseda dhe kuvende e kanë

fjalën e matur mirë, janë shumë të kujdesshëm e të durueshëm. Por, kur t'i prekësh, nuk durojnë as fyerjen më të vogël, e as nuk falin" (Mihaçeviq, L., 2006:100).

Jo pak autorë të huaj përpiqen t'i paraqesin shqiptarët si njerëz të paaftë për të ndërtuar një rrjet marrëdhëniesh shoqërore gjithëpërfshirëse me pikësnyime të caktuara. Në një libër të botuar vitet e fundit, autori austriak Dr. Hubert Neurwirth, e interpreton historinë e Shqipërisë si gjedhë kulturore të mikut dhe armikut, të përcaktuar kryesisht mbi bazën e lidhjeve fisnore. "Grupi i veçuar i prejardhur, - shkruan ai, - kishte shumë armiq: hollë-hollë, cilido që i përkiste atij, ishte mik dhe cilido që nuk i përkiste, një armik potencial" (Neurwirth, H., 2006:11). Dhe vetëkuptohet se çdo shqiptar kishte më pak anëtarë të fisit se të tjerë, jashtë bashkësisë fisnore, pra sipas këtij konceptioni, kishte më shumë armiq se miq. Nga ky këndvështrim, çdo shqiptar kishte, si të thuash, fushë sociale më të gjerë konfliktimi sesa sferë bashkëpunimi miqësor me të tjerët.

Në këtë aspekt, shqiptarët shpërfaqen me pamje krejt të ndryshme, gati të kundërt në krahasim me popujt e tjerë evropianë e më gjerë. Përgjithësisht, janë më pak tolerantë se evropianët për shumë çështje të marrëdhënieve me njëri-tjetrin; por janë më tolerantë, më të prirur për mirëkuptim me besimtarët që u përkasin feve të tjera.

Përgjithësisht, studiuesit shqiptarë, si të thuash, nuk kanë arritur të ngrenë dukshëm stekën e argumenteve mbi nivelin e konstatimeve të Faik Konicës. Por, studiuesit shqiptarë, po ashtu, kanë ofruar jo shumë fakte domethënëse që ndriçojnë në mënyrë të pakontestueshme shpirtin tolerant ndërfetar të shqiptarëve, i cili shfaqet përgjithësisht si mirëkuptim, si harmoni ndërfetare.

## II. Fakte të përsëritura shpesh në rrjedhën e kohës

Para se të shtjellojmë kritika të pikëpamjeve më të spikatura dhe disa arsyetime rreth tolerancës, mirëkuptimit ndërfetar të shqiptarëve, po parashtrojmë disa fakte të qëmtuara drejtpërdrejt në mjedise të ndryshme të shoqërisë shqiptare përgjatë 15-16 viteve të fundit.

## *II.1. Një kishë e largët, që afron më shumë muslimanë*

Me një grup të vogël të afërmish, miqsh e shokësh udhëtojmë me një fuoristradë në drejtim të Kepit të Rodonit. Qëndrojmë pak çaste te hyrja e Kalasë së Ishmit për të nderuar kujtimin e piktorit të njohur Ibrahim Kodra, që fle aty në banesën e përjetshme, e cila nuk është larg shtëpisë ku ai ka lindur. Pa dyshim, është biri më i njohur i kësaj krahine brenda dhe jashtë Shqipërisë gjatë shekullit XX. Vijoje edhe 19 kilometra në një rrugë që gjarpëron mes kodrash të buta. Shtëpitë e besimtarëve katolikë janë të përziera pa kurrfarë rregulli me shtëpitë e muslimanëve. Shtëpitë njëkatëshe, të trashëguara nga periudha e regjimit socialist totalitar, po zëvendësohen nga vila të mëdha dy- dhe trekatëshe, mjaft prej të cilave rrethohen nga ballkone të gjera në të gjitha anët. Në arkitekturën e banesave të vjetra dhe të vilave të reja nuk ka pothuajse asnjë element që të identifikojë përkatësinë e tyre fetare. Vetëm mbarështimi i derrave që kullosnin nëpër kopshte, identifikonte një pjesë të familjeve katolike.

Na shoqëron një vendali, ishmak rreth të pesëdhjetë e pesave. Ai është fshatar fjalëpakët, por i zgjuar, njohës i mirë i zonës, i tokës dhe i detit. Mbi të gjitha, ai është njohës i mirë i traditave të zonës. Njeh personalisht shumicën e banorëve.

Ndërkohë që motori i fuoristradës gulçon në atë rrugë të përpjetë me gropa të mëdha, shoferi detyrohet të frenojë “gozhdë” fare pranë një derri që preu rrugën me nxitim. Gjej rastin të nis një bisedë me shoqëruesin:

- Derri është ndoshta kafsha shtëpiake që bën më shumë dëm, të fut në sherr me fqinjët. A kanë shkaktuar derrat ngatërresa ndërmjet katolikëve dhe muslimanëve në këto fshatra?

Në këto fshatra nuk mbahet mend asnjë sherr ndërmjet katolikëve dhe muslimanëve për dëmet që kanë bërë derrat ose për ndonjë hall tjetër. Ata që mbajnë derra, bëjnë shumë kujdes që të mos dëmtojnë komshinjtë. Dhe janë më të kujdesshëm kur komshinjtë janë muslimanë. Këtu, në katundin tonë, është më mirë ta kesh komshiun me fe tjetër, se nuk të bezdis për asgjë, nuk merret me thashetheme, përpiqet të të ndihmojë me ç’ të mundet. Për aq sa mbajmë mend e na kanë thënë gjyshërit tanë, në këto katunde nuk kanë ba gjak me njëri-tjetrin (domethënë nuk kanë

vra njëri-tjetrit – Z.D.) katolikët me muslimanët. Marrëdhëniet ndërmjet komshinjve katolikë dhe muslimanë janë më të mira, sepse ndërmjet tyre nuk përzihen as punët e politikës, të partive, pra ngatërresat që kanë të bëjnë me to. Në katundet tona nuk bëjnë sherr për politikë ata që kanë fe të ndryshme, por zihen ndërmjet tyre ata që besojnë të njëjtën fe.

– Pse ndodh kështu? – e shtyj më tutje bisedën.

– Ndoshta, – rrudhi supet ai, – nuk them ndonjë gjë për të qenë, por më kujtohet se gjyshi im, i cili falej çdo ditë në xhami, kur isha në shkollën shtatëvjeçare (atëherë shteti nuk i kishte mbyllur kishat dhe xhamitë), këmbëngulte shpesh: “E di që je çapken e të kruhen grushtet të bësh sherr me shokët, por unë dua të ma shkosh hatrin (të më plotësosh dëshirën – Z.D.) vetëm për një gjë: mos m’u ngatërro me fëmijët e kaurëve. Edhe po të gërganë (ngacmuan – Z.D.), bëje një sy qorr dhe një vesh shurdh. Njeriu që shkon në kishë ka në shpirt një send (diçka – Z.D.), ndryshe nga ne që shkojmë në xhami. Njeriut me diçka ndryshe në shpirt hapi rrugë, mos ia shif as të veshmen, as të sjellmen”. Nuk e di a merrnin këto këshilla nga prindërit e tyre shokët e mi të shkollës. Por mbaj mend që në shkollën tonë nuk ka pasur asnjëherë sherr ndërmjet nxënësve katolikë dhe muslimanë.

Në skajin veri-perëndimor të luginës ngrihet kisha katolike e Shën Ndout. E restauruar me fondet e Ambasadës Gjermane, ajo paraqitet në variantin e saj më të vogël. Fragmentet e mureve që shtrihen kryq e tërthor, afër dhe larg kishës, deri te pjesët më të mirëmbajtura të kalasë së Skënderbeut, e cila aktualisht shtrihet në det e në stere, dëshmojnë se kjo kishë, kur funksiononte me kapacitet të plotë, duhet të ketë qenë shumë më e madhe.

Grupi ynë i vogël ulet në bar-kafenë e vetme që është në anë të rërës së detit. Ndoshta bar-kafeja që nuk ka të ngjashmen e vet në asnjë vend tjetër të botës: një adaptim fare i thjeshtë i pjesës së përparme të një tuneli të madh, që gjatë periudhës së regjimit socialist totalitar është përdorur nga ushtria për të magazinuar karburantin që do t’i nevojitej në situata lufte bazës detare luftarake të Shëngjinit dhe avionëve luftarakë të aeroportit të Gjadrit. Jemi ne që futemi të parët në këtë bar-kafe. Pronari, që luan edhe rolin e kamerierit, na përshëndet nga larg me shprehjen “Paçi këmbën e mbarë e ju priftë e mbara për çfarë ju do e bardha zemër!”, afrohet

për të na dhënë dorën dhe për të marrë porositë. Pasi sjell porositë, ulet të ndërrojë një muhabet me ne si klientë të njohur prej 5-6 vitesh. Është një burrë me moshë gati të papërcaktuar, që flet fare pak, por nuk i bie fjala në tokë, siç thuhet në këto anë. Si pa qëllim, hap unë një “xhep” në bisedë:

- Besoj që më shumë klientelë ju siguron kisha se deti. Për më tepër, ata që hyjnë në kishë janë me shpenzime, se e kanë të lejuar të kthejnë këtu ndonjë gotë verë, raki ose ndonjë shishe birra.

- Më të shumtët e njerëzve këtu vijnë për kishën dhe jo për detin, se det kanë edhe në Shën Pjetër. Por ata që hyjnë në kishë, sikur janë të gjithë hoxhallarë, mazellah se vënë në buzë gotë alkooli. Prandaj rrallë mbaj birra në lokal, se mund të më priset, mbaj raki e verë të bërë nga fshatarët, se nuk prishen. Vetëm të krishterët, kur dalin nga kisha, e kthejnë ndonjë gotë verë të kuqe. Por ata që pinë verë në këtë lokal, numërohen me gishta.

Nga vëzhgimet e shumta, të kohëpaskohshme, rezulton se në Shqipëri ka një kategori muslimanësh, që, ndonëse të pakët, sa më shumë besojnë muslimanët, aq më të prirur janë të frekuentojnë jo vetëm xhamitë e vendet e tjera të shenjta muslimane, por edhe kishat e vendet e shenjta të krishtera, sidomos ato të vjetra ose që janë ngritur mbi rrënojat e kishave të vjetra. Ndër besimtarë muslimanë, veçanërisht ndërmjet atyre që nuk u ecën jeta mbarë ose kanë pasur fatkeqësi, është e përhapur mendësia: “Nuk na ecën mbarë ndoshta nga mëkati që kanë bërë të parët tanë që braktisën kishën për të shkuar në xhami”.

## *II.2. Më shumë referues muslimanë në konferencën përkujtimore për një prift françeskan: një “tabu” e tejkaluar në sytë e studiuesve të huaj*

Në nëntor të vitit 1995 shoqëroja një studiues holandez, i cili prej shumë vitesh punonte në strukturat studimore të Kryqit të Kuq Ndërkombëtar. Siç pohonte ai vetë, në rolin e sociologut që kontrollonte ecurinë e projekteve kërkimore, kishte vizituar më shumë se 80 për qind të vendeve të ndryshme të botës. Në vitet e luftërave ndërnacionale ai kishte vizituar për disa javë ish-republikat e ish-Jugosllavisë dhe krahinat e saj. Më datë 6 nëntor 1995 me një fuoristradë të Kryqit të Kuq Shqiptar udhëtonim nga Tirana për

në Shkodër në rrugën e vjetër. Lëvizja e ngadalshme e makinës “na jepte” më shumë kohë për të biseduar dhe për të kundruar peizazhin e fshatrave dhe qyteteve pranë rrugës automobilistike. Në të dy anët e rrugës, herë pas here alternoheshin kambanoret e kishave dhe minaret e xhamive si objekte që binin më shumë në sy.

Studiuesi holandez vinte për herë të parë në vendin tonë. Çelte herë pas here biseda për çështje të ndryshme të kulturës shqiptare. Si gjithnjë, përpiqesha të isha konciz në përgjigjet që i jepja studiuesit holandez, duke i ofruar faktet më domethënëse dhe argumentet më të pakundërshtueshme në diskutimet që vazhdonin natyrshëm, por pa ndërprerë. Nuk shprehte kontestime për ato çka unë i parashtroja.

Ndoshta shëmbëllimet e xhamive e të kishave që afroheshin e largoheshin në xhamat e makinës, e nxitën studiuesin holandez të pyeste për marrëdhëniet ndërmjet muslimanëve dhe të krishterëve. Mbase biseda u hap spontanisht, por interesimi i tij për këtë çështje ishte i veçantë. Madje disa pyetje kishin tone provokuese:

- Duke qenë kaq pranë kishat dhe xhamitë, a nuk i bëjnë hije njëra-tjetrës?

- Unë mendoj, - ia ktheva aty për aty, - se i japin dritë njëra-tjetrës, sepse e çojnë dritën në një drejtim.

Pa e fshehur dyshimin, ai u shpreh me gjuhë diplomatike:

- Le të shpresojmë!?

Fillova të rendis fakte dhe argumente në dobi të tezës se në vendin tonë dallimet fetare nuk “funksionojnë” si burim konfliktesh. Përkundrazi, dallimet fetare ndikojnë që shqiptarët të jenë më të matur në marrëdhëniet me njëri-tjetrin, të jenë më të prirur të harmonizojnë interesat ndërmjet tyre. Herë pas here, studiuesi holandez artikulonte shprehjen “Le të shpresojmë!?” dhe, për të përforcuar mosbesimin në pohimet e mia, e kalonte bisedën në konfliktet e ashpra të shfaqura në politikën shqiptare, ndërmjet politikanëve shqiptarë. Për këtë çështje, biseda u zgjat më shumë se për çdo tjetër. Një kolegu im, që e ndiqte këtë bisedë nga fillimi në fund, më tha të mos vazhdoja më, pasi ashtu si studiuesit e tjerë të huaj, që e njohin më mirë Shqipërinë, dhe aq më tepër ky që vjen për herë të parë, nuk mund të kuptojnë, ose ndoshta, nuk duan të kuptojnë mirëkuptimin ndërmjet shqiptarëve që besojnë në fe të ndryshme.

Pasi kryem detyrimet, për të cilat kishim shkuar në Shkodër, rreth orës 16<sup>00</sup> po ktheheshim në rrugën plot kthesa të vogla që shtrihet në anë të ish-kënetës së Torovicës. Ndonëse mjegulla e dendur e vështirësonte udhëtimin, makina jonë ecte me shpejtësi.

Në një kthesë pa sheshpamje, makina jonë gati sa nuk u përplas me një kamionçinë që vinte përballë. Kur frenuan me ngut, gati vetëm një pëllëmbë hapësirë i ndante fenerët e dy makinave. Pasi shoferët i zbrapsën makinat për disa metra për t'i hapur rrugë njëri-tjetrit, nisëm të udhëtonim edhe më shpejt. Studiuesi holandez dukej mjaft i tronditur. Pasi e mori disa veten, më tha me gjuhë diplomatike:

- Ne nuk kemi program pasdite, pse nxitojmë kaq shumë?

- Në orën 18<sup>00</sup>, - m'u desh të shpjegohej disa gjatë, - në një nga sallat e ish-muzeut të Enver Hoxhës, zhvillohet një konferencë shkencore, në nderim dhe përkujtim të veprës së priftit të krishterë françeskan shqiptar At Ambroz Marlaskaj, dhe unë kam një referim në këtë konferencë. At Marlaskaj ka qenë jo vetëm një prift françeskan nga më të shquarit, por edhe një veprimtar shoqëror, deputet i krahut më përparimtar në parlamentin shqiptar gjatë viteve '20 të shekullit XX, një publicist, eseist e studiues i klasit të parë. Në vitet 1934-1939 At Marlaskaj ka dhënë leksione teologjie si pedagog i brendshëm në Institutin Internacional Antonian të Romës. Në këtë konferencë - gjej rastin t'i theksoj studiuesit holandez - do të mbahen 5 referate: I pari do të paraqitet nga shefi i françeskanëve shqiptarë, At Zef Pëllumbi, një prift që ka vuajtur më shumë se 18 vite në burgjet e shtetit socialist totalitar, pastaj do të referojnë njëri pas tjetrit dy muslimanë syni, një bektashi dhe, në fund, do ta mbyllë konferencën referati i një besimtari të krishterë i orientimit françeskan.

- Ju nga mbiemri dukeni bektashi, - më tha studiuesi holandez.

- Mbiemri "dervishi", - i përgjigjem, - përdoret më shumë nga bektashinjtë, por ka edhe muslimanë syni me këtë mbiemër. Unë rrjedh nga një fis muslimanësh syni, i cili, në disa breza, ka pasur klerikë muslimanë profesionistë të arsimuar kryesisht në Stamboll. Gjyshi ka qenë sheh i kualifikuar. Këtë traditë e ndërpreu babai, i cili ka punuar si mësues.

Studiuesi holandez mori pjesë në konferencën shkencore. Përvoja e tij shumëvjeçare si studiues në mjedise nga më të ndryshimet të shoqërive të krishtera dhe muslimane e ndihmonte atë të deshifronte përkatësinë fetare të referuesve nga emrat dhe mbiemrat e tyre. Kur mbaroi konferenca, studiuesi holandez dukej disi i hutuar dhe si i zënë në faj. Sapo u ulëm në bar-kafe më tha:

- Ju kërkoj ndjesë. Argumentet tuaja për mirëkuptimin ndërmjet besimtarëve me përkatësi fetare të ndryshme, ndonëse ishin interesante dhe logjiksht të kalkuluara, më ngjallnin një hije dyshimi. Kjo konferencë më hoqi çdo dyshim, është një dëshmi e gjallë, publike, e pakontestueshme e mirëkuptimit të shqiptarëve që u përkasin organizatave fetare të ndryshme.

### *II. 3. Shpresë për kurim*

Krahina e Prezës shtrihet në veri-perëndim të Tiranës, jo më larg se 23 kilometra nga qendra e Tiranës, gjendet në majë të kodrës më të lartë, në këmbët e kështjellës, e cila, që nga shekulli II p.e.s deri në fund të shekullit XIX, është ndërtuar, shkatërruar e rindërtuar disa herë. Duke pasur statusin e qytetit ose të qytezës për disa shekuj, Preza ka pasur rrezatim të rëndësishëm subkulturor në rreth 32 fshatra përreth saj. Shumica e banorëve janë muslimanë të orientimit syni. Ka të dhëna që provojnë se islamizmi është përhapur ndër banorët përreth kalasë së Prezës afro 410 vite më parë. Që nga kjo kohë, veçanërisht në Prezë-qendër kanë ushtruar funksione të ndryshme fetare klerikë të niveleve të ndryshme, si: imamë, shehë etj. Shehët, përgjithësisht, shkruanin në gjuhën arabe hajmali ose, siç quhen në dialektin e krahinës, nuska. *Rasti e ka sjellë që unë të jem dëshmitar okular në mjediset ku janë shkruar qindra e qindra nuska të tilla deri në vitin 1971, pra edhe 4 vite pasi u ndalua zyrtarisht funksionimi i organizatave fetare në Shqipëri.* Klerikët që i shkruanin, dhe banorët e krahinës besonin se nuskat shëronin sëmundje të ndryshme, veçanërisht ato psikike, se parandalonin një varg sëmundjesh e shqetësimesh të natyrave të ndryshme, se u sillnin shëndet të mirë e mbarësi në punë e në jetë sidomos të rinjve e të rejave, se i mbronin njerëzit, veçanërisht fëmijët e nusët e reja, nga ndikimet e magjive dhe të syrit të keq etj. Një

nga njohëset më të kualifikuara të kulturës tradicionale shqiptare, Edith Durham, në vitet '30 të shekullit XX, shkruante: "Syri i keq është një nga mallkimet e Shqipërisë. Nëpër gjithë vendin njerëzit mbajnë hajmali kundër tij." (1990:143)

Hajmali të tilla, të shkruara në arabisht nga hoxhallarët, mbanin në trup vazhdimisht ose për shumë vite jo vetëm besimtarë muslimanë, por edhe besimtarë katolikë, që banonin në fshatrat përreth Prezës, si: Bilaj, Murqinë, Bubq, Mallkuç etj. Edith Durham, gjatë tre dhjetëvjeçarëve të parë të shekullit XX, përshkruan disa raste të besimtarëve katolikë që banonin në Shqipërinë Veriore dhe në Kosovë, të cilët kërkonin ndihmën e klerikëve muslimanë syni dhe bektashi për t'u shëruar nga sëmundje të ndryshme, veçanërisht nga magjitë. (1990:511-514)

Madje shpesh, të krishterët, të cilët besonin se ishin shëruar vetë ose fëmijët e të afërmit e tyre nga hajmali, miqësoheshin me hoxhallarët që u kishin përgatitur shkrime-lutje në arabisht me përmbajtje fetare. Miqësi të tilla ndërmjet familjeve, fiseve të hoxhallarëve dhe fiseve katolike trashëgoheshin në disa breza.

Hoxhallarët priteshin e përcilleshin me nderime të veçanta në familjet e katolikëve: për ta nuk servirej mishi i dërrit dhe pijet alkoolike. Madje, disa familje mbanin enë kuzhine të veçanta, të cilat i përdornin vetëm në rastet kur ata prisnin miq muslimanë, veçanërisht hoxhallarë. Për arsye fetare, priftërinjtë katolikë nuk merrnin pjesë ose merrnin pjesë vetëm në elemente të veçanta të ceremonive komplekse e të stërzgatura të dasmave. Ndodhte shpesh, sidomos në krahinën e Prezës dhe të fshatrave përreth saj, që në krye të krushqve të krishterë që shkonin të merrnin një nuse të krishterë, të veshur të gjithën me veshje tradicionale të krishtera, të printe hoxha me çallmë. Jo vetëm në ceremoni dasmash, por edhe në situata të tjera, kur familjet e krishtera ftonin muslimanë dhe sidomos hoxhallarë, i nderonin në mënyrë të veçantë, i vinin në krye të vendit.

### III. Interpretime të paplota

Së paku, që nga shekulli XVII deri në ditët tona, mjaft udhëpërshkrues dhe studiues të huaj janë përpjekur të vlerësojnë rrënjët sociale, psikokulturore dhe fetare të tolerancës, të

mirëkuptimit ndërftar të shqiptarëve. Pikëpamjet e tyre për këtë problematikë mund të klasifikohen në këto linja kryesore:

1. E kaluara pagane e popullit shqiptar ka ndikime të ndjeshme në besimet fetare monoteiste të shqiptarëve. Madje, ka studiues ose udhëpërshkrues të huaj, si për shembull, Edith Durham që ka shkruar se “një pjesë e shqiptarëve... kanë kaluar direkt nga paganizmi në islamizëm” (Durham, E., 1990:158). Mendojmë se kjo është një hipotezë mjaft e përgjithshme që nuk ndriçon asnjë aspekt të kësaj dukurie mjaft komplekse.

*E para*, nuk ka fakte e dokumente të mjaftueshme që të provojnë se një pjesë e shqiptarëve kanë kaluar nga paganizmi në fenë monoteiste myslimane, pa kaluar nga besimi fetar i krishterë.

*E dyta*, elemente të veçanta të paganizmit, në trajtën e elementeve të kulturës së jetesës, shfaqen edhe në mënyrën e jetesës të besimtarëve të feve të tjera në Evropë dhe më gjerë. Një nga themeluesit kryesorë të sociologjisë, që ka studiuar me përparësi edhe problematikën sociokulturore të besimeve fetare, Emile Durkheim, ka shkruar: “Mund të thuhet se s’ka sistem fetar, të lashtë apo të ri, në të cilin, në forma të ndryshme, të mos hasim krah për krah dy fe të ndryshme. Megjithëse të lidhura ngushtë, madje duke depërtuar njëra në tjetrën, ato mbeten të dalluara. Njëra u drejtohet gjërave të natyrës – qoftë forcave të mëdha kozmike, të tilla si erërat, lumenjtë, yjet, qielli, etj., qoftë forcave të çdo lloji që popullojnë sipërfaqen e tokës si bimët, kafshët, shkëmbinjtë, etj. Për këtë arsye i është dhënë emri *natyrizëm*. Tjetra ka për objekt qeniet shpirtërore – frymët, shpirtat, orët, xhindet, hyjnitë e mirëfillta, agjentë të gjallë dhe të vetëdijshëm si njeriu, por që ndryshojnë prej tij nga natyra e fuqive që u vishen, dhe sidomos nga karakteristika e posaçme se nuk prekin njëlloj shqisat; zakonisht, ato nuk perceptohen prej syve të njeriut. Kjo fe e shpirtave quhet *animizëm*. Dy teori të papajtueshme janë parashtruar për të shpjeguar bashkekzistencën pak a shumë universale të këtyre dy llojeve të kulteve. Disa janë të mendjes se animizmi ka qenë feja parësore dhe natyrizmi vetëm një formë e prejardhur dhe dytësore. Të tjerë, përkundrazi, kanë pikëpamjen që kulti i natyrës ka qenë pikënisja e evolucionit fetar dhe kulti i shpirtave është vetëm një rast i veçantë i tij” (2000:54). Kësisoj, sikurse në vende të tjera, edhe në Shqipëri sistemet fetare ndërftun

në çështje të veçanta me njëri-tjetrin, madje edhe me elemente të paganizmit. Mirëpo në vende të tjera, një ndërfitje e tillë, bile edhe i varianteve të ndryshme të të njëjtit besim, nuk ka funksionuar si faktor që kultivon tolerancën ndërfitare. Natyrisht, edhe në Shqipëri ndërfitjet e dukshme e të padukshme të sistemeve fetare nuk ka se si të kultivojnë tolerancën ndërfitare.

2. Autorë të huaj janë përpjekur të provojnë lidhje të zbehta të shqiptarëve me fetë e mëdha monoteiste, si ortodoksizmi, katolicizmi dhe muslimanizmi, pasi këto fe janë imponuar nga pushtues të ndryshëm ose, të paktën, janë të ardhura nga jashtë (Elsie, R., 2005:20). Por kjo formë e përhapjes së këtyre feve në shoqërinë shqiptare nuk është tipike shqiptare.

Sipas studiuesit Ernst Troeltsch, që kur është themeluar si kult në Lindjen e Mesme, krishterimi u përhap shkallë-shkallë në vende të tjera të Evropës e më gjerë nëpërmjet difuzionit dhe autoritetit shtetëror të perandorive të mëdha që e shtrinin pushtetin e tyre politik e ushtarak, ekonomik e kulturor në territore të gjera, ndër popuj të ndryshëm mund të themi se në sfondin e zhvillimeve e të përvojave botërore një "argument" i tillë shkrihet si kripa në ujë dhe nuk ndihmon aspak për të shpjeguar "funksionimin" e vlerës kulturore të tolerancës, të mirëkuptimit ndërfitar të shqiptarëve.

3. Disa udhëpërshkrues dhe studiues të huaj, në harkun kohor të disa shekujve e interpretojnë tolerancën ndërfitare të shqiptarëve si rezultante të cektësisë së ndjenjave të tyre fetare, të formimit teoriko-fetar të sipërfaqshëm. Për shembull, një nga udhëpërshkruesit më me përvojë të Perandorisë Turke, Evlia Çelebi, i cili gjatë shekullit XVII ka vizituar shumë qytete e krahina rurale të Shqipërisë, ka shkruar se shqiptarët "nuk çajnë krye për doktrinën fetare" (Çelebi, E., 2000:53). Rreth dy shekuj e gjysmë më vonë, Edith Durham, në ditarin e saj analitik udhëpërshkrues, do të nënvizonte: "Ka kombe që kanë prirje për fenë. Kurse shqiptarët, si komb, për çudi, s' duan t'ia dinë për fenë... Shqiptari krishterimin nuk e ka marrë kurrë seriozisht, por edhe islamizmi, me ç' duket, nuk është futur si duhet" (1990:45). Ndërsa në artikullin "Disa mendime mbi fenomenin e konvertimit në islamizëm duke u nisur nga rasti i katolikëve shqiptarë, i vëzhguar nga një mision jezuit nga fundi i epokës osmane" Nathalie Clayer, veç të tjerash,

ka shkruar se shqiptarët karakterizohen nga “sipërfaqësi e fesë”, nga “lidhje të dobëta me fenë”, nga një “formim fetar dhe pra nga njohje të dogmës dhe të praktikave fetare shumë sipërfaqësore”, se “shqiptarët janë shumë të ftohtë me fenë” etj. (2006:125, 127, 129, 142). Gjithashtu, edhe specialistja e antropologjisë sociale, pedagogia e Universitetit të Kembrixhit, Clarissa de Waal, e cila ka kryer një ekspeditë studimore në shoqërinë shqiptare paskomuniste gjatë viteve '90 të shekullit XX, nuk arrin të dalë nga konturet e një mendimi të tillë. Veç të tjerash, ajo ka shkruar se të krishterët shqiptarë, sidomos në Mirditë “nuk u mbahen rregullisht ditëve të shenjta dhe zor se shkojnë ndonjëherë në kishë”, “se katolicizmi nuk ishte burim entuziazmi në praktikë dhe as model sjelljeje” (Waal, C., 2005: 91, 92).

Mendoj se nuk është e sipërfaqshme ndjenja fetare e shqiptarëve, por është e pamjaftueshme njohja e studiuesve dhe udhëpërshkruesve të huaj për një ndjenjë të tillë. Këtë përfundim e vërtetojnë fakte të shumta, të pakundërshtueshme të realitetit fetar në Shqipëri.

Së pari, vazhdimisht gjatë 3-4 shekujve të fundit, ndonëse mjaft i varfër, populli shqiptar ka pasur densitet të lartë të kishave, të xhamive, të teqeve, të tyrbeve e të vendeve të tjera të shenjta. Kështu për shembull, në fillim të shekullit XX, siç ka shkruar Th. Ippen, vetëm në Krujë ka pasur rreth 366 xhami, teqe, tyrbe e vende të tjera të shenjta (Shih: Revista “Të drejtat e njeriut”, 1996, nr. 2, f. 28). Në atë kohë, sipas të dhënave statistikore të përafërta, qyteti i Krujës kishte rreth 3-4 mijë banorë. Nga një përlllogaritje e thjeshtë rezulton se në Krujë funksiononte një institucion i shenjtë për mesatarisht 10 banorë ose, përafërsisht, dy vende të shenjta për tre familje. Ndërkohë, që nga fillimi i viteve '90 të shekullit XX deri në ditët tona në Krujë janë rikonstruktuar mjaft prej teqeve, tyrbeve dhe vendeve të shenjta që kanë funksionuar më parë. Madje, në disa raste janë ndërtuar teqe edhe në vende ku s'kanë funksionuar deri në vitin 1967. A mund të ishin dhe të jenë me ndjenja fetare të cekëta banorët e Krujës që kishin dhe kanë ndërtuar, kujdeseshin dhe kujdesen për të mirëmbajtur kaq shumë institucione fetare për frymë të popullsisë?

Së dyti, në shoqërinë shqiptare, sidomos që nga shekulli XVI deri në fund të shekullit XIX, ka funksionuar dukuria e kriptokristianizmit si një dukuri mjaft komplekse (Roka, R., 1994:

24-25). Në periudhën disashekullore të pushtimit të Shqipërisë nga Perandoria turko-osmane, konvertimi nga të krishterë në muslimanë, përgjithësisht, u siguronte shqiptarëve mjaft përfitime si mundësi më të gjera për t'u pasuruar, për të përparuar në karrierën politike, administrative, ushtarake e kulturore etj.

Organet përkatëse të regjimit totalitar të pushtimit shikonin me dyshim çdo lidhje të fshehtë me fenë e mëparshme të shqiptarëve të konvertuar në muslimanë. Megjithëkëtë, një numër i konsiderueshëm muslimanësh shqiptarë, në rrjedhën e disa brezave, ushtronin në fshehtësi (ose, më saktësisht në gjysmëfshehtësi, pasi nënat, gratë, vajzat e tyre ndiqnin hapur ritet kishtarë), ritet fetare të krishtera. Vetëkuptohet se, po të mos kishin ndjenja fetare të thella, mjaft shqiptarë nuk kishin pse të rrezikonin përballë autoriteteve turke të pushtimit, duke i kthyer sytë prapa te feja e mëparshme. Ndjenjat fetare të cekëta, të sipërfaqshme, nuk do të përligjinin dukurinë e kriptokristianizmit.

*Së treti*, gjatë periudhës së regjimit socialist totalitar, më së shumti të krishterët, siç ka konstatuar edhe antropologia angleze Clarissa de Waal, parapëlqenin t'u vinin fëmijëve të tyre emra katolikë, ç'ka i ekspozonte si kundërshtarë të politikës zyrtare të regjimit në këtë aspekt. Po të mos kishin ndjenja fetare të qëndrueshme, besimtarët, veçanërisht ata katolikë, nuk do të pagëzonin fëmijët e tyre me emra të traditës fetare të konsoliduar.

*Së katërti*, veçanërisht gjatë shekujve XVIII dhe XIX, në historinë e Shqipërisë janë konstatuar edhe konvertime dhe rikonvertime në grup, brenda ditës, të një numri të konsiderueshëm shqiptarësh nga të krishterë në muslimanë. Nathalie Clayer përshkruan një rast të konvertimit në muslimanë ditën e Pashkëve në fund të shekullit XVIII të banorëve të Anamalit të nxitur, ndër të tjera, edhe nga pakënaqësia ndaj priftit, nga mosmarrëveshjet me të: "Kur banorët arritën në kishë (kishte vetëm një të tillë në gjithë krahinën) prifti e kishte bërë meshën. Kur banorët i kërkuan të bënte një tjetër për ata, prifti u përgjigj se nuk ishte e mundur që mesha të bëhej dy herë. Ata u zemëruan aq shumë sa shkuan të gjithë në xhami" (Clayer, N., 2006:135). Fakte të tilla provojnë se përgjithësisht shqiptarët mund të mos kenë respektin e duhur për klerikë të veçantë, sidomos për ata që abuzojnë në një formë ose tjetër me çështje të ritualeve, por nuk provojnë se shqiptarët

kanë ndjenja të cekëta fetare. Përkundrazi, fakte të kësaj natyre provojnë se shqiptarët në fund të shekullit XIX e kanë pasur mjaft të zhvilluar ndjenjën fetare. Sociologu Gillen ka argumentuar se përgjithësisht ndjenja të tilla janë të qëndrueshme në harkun kohor të shumë viteve që e kapërcejnë një shekull.

Jo rrallë, studiues të huaj dhe shqiptarë kanë konfunduar mungesën e respektit të besimtarëve shqiptarë për klerikë të caktuar me indiferentizmin ndaj çështjeve të besimit fetar. Në trashëgiminë folklorike të popullit shqiptar ka një fond të konsiderueshëm në këngë, anekdota, rrëfenja, proverba etj., të cilat stigmatizojnë vese të ndryshme të klerikëve muslimanë e të krishterë, por pothuajse nuk gjendet asnjë krijim me profil ateist të spikatur. Në vitin 1983, pra në kohën e imponimit zyrtar të ateizmit, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë botoi vëllimin “Fjalë të urta të popullit shqiptar”. Ky është vëllimi më i gjerë i botuar në gjuhën shqipe dhe përmban 13910 proverba. Në rubrikën “Feja dhe kleri” botohen 52 proverba, prej të cilave vetëm njëra shpreh një farë indiferentizmi ndaj Perëndisë dhe kjo duket si e sajuar enkas për t’iu përmbajtur kornizës ateiste të imponuar nga regjimi socialist totalitar. Ndërsa të tjerat, në forma dhe në masa të caktuara, përçmojnë klerikët e të gjitha organizatave fetare (IKP, 1983:949-954) që kanë funksionuar në Shqipëri.

Atëherë, si shpjegohet që shqiptarët jo vetëm janë tolerantë, por janë të prirur të mirëkuptohen me përparësi me bashkëkombësit me përkatësi tjetër fetare?

#### IV. Një sprovë shpjegimore

Mendojmë se zembereku i funksionimit me kapacitet të plotë të vlerës kulturore të tolerancës, të mirëkuptimit ndërfaqetarak ka të bëjë me një profil të qenësishëm të modelimit psikokulturor të popullit shqiptar, i cili është rilevuar, ndonëse fare zbehtë, nga studiuesit më të kualifikuar të konstruksionit shpirtëror të shqiptarëve. Edith Durham ka shkruar se shqiptari “ka instinktin e një fisniku” (1990: 544). Ndërkohë, Faik Konica ka argumentuar se shqiptarët i kanë mbetur besnikë traditës kalorësiake për ta kursyer, për të mos e keqtrajtuar kundërshtarin ose konkurrentin e mundur (2001: 221). Dhe konkurrentët e mundur shfaqen jo vetëm në fushën ekonomike

e politike, por edhe në atë kulturore, fetare dhe demografike. Siç kanë vënë në dukje edhe studiues joshqiptarë, pjesë përbërëse e këtij profili në formimin psikokulturor të shqiptarëve është mungesa e instinktit të turmës. Në mesin e viteve '20 të shekullit XX, studiuesi gjerman dr. Herbert Luis, i cili e ka njohur nga afër shoqërinë shqiptare, ka shkruar se “në Shqipëri nuk ekziston një dukuri e tillë si turma” (Shih: Konica, F., 2001: 232). Të çliruar nga instinktet e turmave, shqiptarët asnjëherë nuk kanë keqtrajtuar grupet sociale në pakicë, të formuara mbi baza racore, etnike, nacionale, fetare etj. Historikisht dhe aktualisht grupet sociale në pakicë, si të thuash, kanë qenë dhe janë të mbrojtura nga toleranca, prirja për mirëkuptim dhe fryma humane e grupeve sociale në shumicë.

Madje, sa më të shpërpjesëtuar të jenë raportet numeriko-demografike ndërmjet grupit të njerëzve me përkatësi fetare të njëjtë në pakicë dhe grupit me përkatësi tjetër fetare në shumicë, aq më e mirëkuptuar është pakica nga shumica.

Sipas normave të kulturës tradicionale shqiptare, kur në fshat ose krahinë, e cila përgjithësisht funksiononte si një strukturë fisnore kompakte, sistemohej me banim një familje e një fisi tjetër ose e ardhur nga zonat më të largëta të Shqipërisë, të ardhurit në pakicë fitonin të gjitha të drejtat si vendalinjte që ishin numerikisht në shumicë. Një nga njohësit më të kualifikuar të normave të kulturës tradicionale shqiptare, Dom Frano Illia, ka shkruar: “Si çdo shtëpi e katundit, edhe shtëpia e ardhur risht, i ka të gjitha të drejtat e përgjithta në katund e bajrak, për sa i përket kohës që gjindet aty” (1993:129). Opinioni i shoqërisë tradicionale shqiptare përgjithësisht e përçmonte më shumë një anëtar të fisit, një banor të kahershëm të fshatit, i cili nuk ndihmonte sa e si duhet të ardhurit, e aq më tepër, nëse i keqtrajtonte ata që përbënin një pakicë fare të vogël dhe, sidomos, kur një pakicë e tillë ishte me përkatësi tjetër racore, etnike, nacionale, fetare etj. Në shoqërinë tradicionale shqiptare kanë qenë mjaft të përhapura, gati imponuese mendësitë së “është paburrni me u mat (domethënë të bësh sherr - Z.D.) me atë familje ose fis që ka ma pak meshkuj se familja ose fisi jot”, se “është paburrni të matesh me më të dobëtin në kamje ose numër burrash”, se “është burrni t’i lëshosh rrugë më të dobëtit” etj. Me përjashtime fare të rralla, në shoqërinë

shqiptare në shumë aspekte je më i favorizuar, nëse je anëtar i grupeve sociale në pakicë, sesa anëtar i grupeve sociale në shumicë. **Në rrafshin fetar ky përfundim lipset të mos keqinterpretohet, të mos u adresohet vetëm besimtarëve muslimanë, të cilët përbëjnë grupin e popullsisë në shumicë në shoqërinë shqiptare aktualisht dhe në një hark kohor të së kaluarës, që shtrihet, ndoshta, deri në çerekun e parë të shekullit XVII** (Elsie, R., 2005: 88). Përpjesëtimi i grupeve sociale në pakicë dhe në shumicë sipas përkatësisë fetare ka ndryshuar që nga shekulli XV. Në fillimet e përhapjes së islamizmit në vendin tonë dhe përgjatë më se dy shekujve në vijim, të krishterët ishin në shumicë. Për një kohë relativisht të gjatë, besimtarët e krishterë e ruajtën këtë status demografik. Brenda këtyre raporteve numerike, mekanizmi i vlerës së tolerancës fetare funksiononte shumë mirë. Profili human i grupit social ose fetar në shumicë në raport me grupet e tjera sociale ose fetare në pakicë shfaqet veprues ndër shqiptarët pavarësisht nga përkatësia e tyre fetare. Një profil i tillë, si të thuash, ka funksionuar si hapësirë shpirtërore që ka mundësuar përhapjen në Shqipëri në trajtën e kulteve (Macionis, J., 2005:) gjatë 15 viteve të fundit të mjaft besimeve fetare që nuk kanë ekzistuar më parë në shoqërinë tonë. Sipas dokumenteve që gjenden në zyrën përkatëse pranë Këshillit të Ministrave, në shtator 2003, në Republikën e Shqipërisë vepronin rreth 53 shoqata e fondacione, të cilat, në veprimtarinë e tyre, zbatojnë edhe disa elemente fetare jashtë traditës shqiptare, si: “Vëllezërit Ungjillorë”, “Dëshmitarët e Jehovahit”, “Bashkimi i Misionarëve Ndërkombëtarë Baptistë”, “Qendra Sociale “Don Bosco””, “Fondacioni “Liahona” i Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Mëvonshëm”, “Fondacioni Kristian Ndërkombëtar”, “Fondacioni “BAHAI””, “Organizata Islamike e Ndihmave të Arabisë Saudite”, “Shoqata Ndërkombëtare e Ndihmës “TAIBAH””, “Shoqata “Gjysmëhëna e Kuqe””, “Fondacioni i Xhematit Musliman Ahmadia e Shqipërisë” etj. Me përjashtim të rasteve të rralla, anëtarët që funksionojnë prej shumë kohësh në Shqipëri nuk kanë reaguar ashpër ndaj përhapjes së këtyre organizatave me profil kulti fetar, të cilat e pasuruan shumë mozaikun e diversitetit fetar në shoqërinë shqiptare.